

RREGULLA PËR SEZONIN E VJESHTES 2017-2018

Këto rregulla janë unike për të gjithë studentët në të gjitha ciklet e studimit: BA,MP dhe MSC.

Për sezonin e vjeshtës 2017-2018 studentët duhet të regjistrohen vetë në lëndët që do të japin provim.

Më poshtë tregohen rregullat dhe procedura e regjistrimit në sezonin e vjeshtës 2017-2018.

1. Sezoni i vjeshtës 2017-2018 është: 5 shtator - 18 shtator 2018.
2. Sa ditë sezoni do të jenë në vjeshtë ?.....(14)
Datat e Sezonit të Vjeshtës janë: 5-6-7-8-9-10-11-12-13-14-15-16-17-18 shtator 2018.
3. Për një lëndë të caktuar sa data provimesh do të lihen ?.....(1)
4. Në sa provime mund të futet studenti në një ditë ?.....(deri ne 2 provime)
5. Sa provime gjithsej mund të japë studenti në sezonin e vjeshtës?.....(14)
6. Studenti mund të prenotohet vetëm një herë për të njëjtin provim.
7. Për sezonin e vjeshtës regjistrimi i studentëve për provime do të përfshijë periudhën 28 gusht – 4 shtator 2018.
8. Pas kësaj date asnjë student nuk mund të kryejë veprime për regjistrime në provimet e sezonit të vjeshtës.
9. Në provimet e vjeshtës nuk mund të futen studentët që s'kanë bere pagesën per vitin akademik 2017-2018 apo kane pagesa te prapambetura nga vitet akademike te kaluara .
10. Të gjithë studentët e viteve të dyta (të rregullt apo përsëritës) të cilët kanë patur lëndë të pafrekuentuara gjatë viteve të mëparshme akademike, por që i kanë frekuentuar ato në vitin akademik 2017-2018 duhet të verifikojnë në sistem nëse pedagogu i lëndës i ka vendosur frekuentimin përndryshe studenti nuk mund të regjistrohet dot në këtë provim për sezonin e vjeshtës 2017-2018.
11. Kujtojmë se për tu regjistruar në sezonin e vjeshtës të gjithë studentët duhet të kenë frekuentuar lëndët përkatëse dhe të jenë të pajisur me të dhënat që ata kanë vendosur vetë, për të hyrë në sistemin digjital.
12. N.q.s studentët kanë problem me këto të dhëna atëhere të komunikojnë sa më shpejt me sekretaritet mësimore të fakultetit përkatës për tu njohur me to.
13. Manuali për regjistrimin në provimet e sezonit të vjeshtës do të mund ta shkarkoni dhe nga websiti i universitetit: <http://www.unkorce.edu.al>.